



Distancimi social dhe qasja e të rinjve të shkollave të mesme me teknologjinë e informacionit dhe komunikimit.

[Organizata LIBURNETIK](#) me mbështetjen e [Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë](#) (OSFA), në bashkëpunim me [Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë](#) dhe në partneritet me [Kongresin Rinor Kombëtar](#) për të tretin vit radhazi është duke zbatuar projektin “[Re-Debate 5.0, Kampionati Kombëtar i Debatit](#)”.

Pas përfundimit të fazës së trajnimeve në 17 qytete Tetor 2019 – Janar 2020, faza e II e projektit do të duhej të vazhdonte në muajt Mars dhe Prill 2020 me zhvillimin e debateve në nivel qyteti me 50 shkollat e përzgjedhura në këtë edicion. Kjo periudhë përkoi me emergjencën COVID-19 dhe si rrjedhojë, me pezullimin e aktiviteteve tona.

Nisur edhe nga udhëzimet zyrtare ekipi ynë është duke respektuar vetë izolimin dhe të njëjtën gjë ka kërkuar edhe për pjesëmarrësit e këtij projekti, nxënësit dhe mësuesit, shëndeti i të cilëve është thelbësor për ne.

Në kuadër të vazhdimësisë së projektit, ekipi i Re-Debate 5.0 ndërmori një pyetësor për të vlerësuar kapacitetet dhe mundësitë që kanë nxënësit dhe mësuesit pjesëmarrës për të arritur rezultatet e projektit përmes përdorimit të teknologjisë për të zbatuar fazën e debateve në nivel qyteti.


Projekti zbatohet në 17 qytete Shkodër, Lezhë, Kukës, Kamëz, Durrës, Shijak, Rrëshen, Burrel, Krujë, Fushë-Krujë, Tiranë, Elbasan, Pogradec, Korçë, Fier, Vlorë dhe Sarandë duke përfshirë 50 shkolla të mesme publike dhe private. Pyetësi ju dërgua të gjithë nxënësve të përfshirë në projekt dhe ata që u përgjigjën janë: 21.84% nga Tirana, 8.86% nga Fieri, 8.23% nga Durrësi dhe 7.91% nga Vlora. Pjesa tjetër e të anketuarëve përfaqësojnë një përqindje më të vogël nga qytetet e tjera pjesë e projektit. Pjesa më e madhe e nxënësve që i janë përgjigjur pyetësorit janë vajza 64.24% dhe 22.15% janë nxënës në klasën X, 44.62% janë në klasën XI dhe 33.23% janë maturantë.

Udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale po ndiqen nga nxënësit ku 55.06% e tyre raportojnë se janë në vetë-izolim në shtëpi dhe 44.62%

janë të vetëkarantinuar sipas rregullave dhe kufizimeve të vendosura. Ndryshe paraqitet situata për mësuesit, ku 75.47% e tyre janë përgjigjur se janë në vetë-izolim dhe të vetëkarantinuar sipas rregullave dhe kufizimeve të vendosura janë 22.64%.

Nga masat shtrënguese si pasojë e pandemisë nga Covid-19 nxënësit raportojnë se 65.82% e tyre janë duke studiuar në distancë nga shtëpia, 20.57% vijon studimin online nëpërmjet platformës digjitale të ofruar nga MASR dhe vetëm 0.32% po ndjekin mësimet nga kanali i RTSH-së. Të angazhuar në procesin e dhënies së mësimit, me një përqindje të lartë janë mësuesit të cilët janë duke punuar në distancë nga shtëpia (94.34%).


Figura 1. Studimi online nga shtëpia në vijim të masave shtrënguese nga pandemia



Referuar infrastrukturës të nevojshme për të kryer mësimin online, të gjithë nxënësit e pyetur konfirmojnë që kanë pajisje në gjendje të mirë pune për të realizuar mësim apo aktivitete të tjera online. Gati shumica (44.62%) kanë laptop ose PC personal në shtëpi dhe pjesa dërrmuese (82.59%) kanë telefon celular personal me kamera. Ndërkaq mësuesit janë përgjigjur me përqindje të përafërt me nxënësit ku 88.68%

e tyre përdorin telefon celular personal me kamera për zhvillimin e mësimeve.

Figura 2. Pajisjet në dispozicion për të realizuar mësimin apo punën online




Interneti përfaqëson sot një nga nevojat më të mëdhaja për të rinjtë dhe 81.96% e nxënësve raportojnë se kanë lidhje wireless me Internet në shtëpi, ndërsa 11.71% përdorin lidhjen nga telefoni (3G/4G). Megjithatë 6.01% raportojnë se nuk kanë lidhje të vazhdueshme me internet e cila mund të ndikonte në realizimin e aktiviteteve online.

Platformat e përdorura për të realizuar mësimin online apo video-konferenca përfaqësohen nga Whatsapp për 56.96% të nxënësve 67.92% e mësuesve që raportojnë se e përdorin, Zoom (25.95% nxënës dhe 22.64% mësues) si edhe platforma të tjera në raportin 30.06%. Platformat e tjera janë në nivel më të ulët por vlen për tu përmendur numri i madh i tyre duke filluar nga Google Classrooms, Google Hangouts, Edmondo, BlueJeans, GoToWebinar, Messenger, Microsoft Teams, Dicord duke treguar numrin e madh të platformave të përdorura.




Për sa i takon përdorimit të platformave online, 31.96% e nxënësve raportojnë se janë shumë familjar dhe në përqindje të barabartë janë edhe ata që janë përgjigjur disi familjar dhe i përdorin me lehtësi ato. Ndërkohë 19.31% e studentëve nuk kanë përdorur ndonjëherë ose i kanë përdorur shumë pak platformat e punës apo mësimin online dhe 17.41% janë mesatarisht familjar në një ose disa platforma. Përveç njohurive që nxënësit mund të kenë me përdorimin e Whatsapp, përdorimi i platformave të tjera ka nevojë për një vlerësim më të thelluar për përzgjedhjen e platformës për tu përdorur për debatet pasi njohuritë e nxënësve janë më të kufizuara. Nga ana tjetër zhvillimi i procesit mësimor në kushtet e vetë-izolimit i mbështetur në platformat e lartë përmendura ka paraqitur vështirësi teknike ndikuar nga mungesa apo ndërprerja e internetit, por edhe e aparaturave për përdorimin e tyre. Kjo për pasojë ka sjellë mungesën e përqendrimit gjatë zhvillimit të mësimin online i cili i përfaqësohet më së shumti në një shkëmbim informacioni ku mungon interaktiviteti nxënës-mësues dhe anasjelltas. Kjo mënyrë e të mësuarit online sikurse janë shprehur nxënësit ka sjellë mangësi të theksuara në përvetësimin e lëndëve, veçanërisht ato shkencore ku hasin boshllëqe. Vështirësi teknike në mbarëvajtjen e orëve të mësimin kanë hasur edhe mësuesit, të cilët kanë theksuar mungesën e pjesëmarrjes së nxënësve gjatë zhvillimit të mësimin nëpërmjet platformave online për shkak të lidhjes së internetit.

Figura 3. Platformat e përdorura për të realizuar video konferenca / mësimin online



Të pyetur se cilat do të ishin nevojat e tyre nëse debatet zhvillohen online, 59.81% e nxënësve raportojnë se kanë nevojë për koordinim me anëtarët e skuadrës dhe mentorin. Ky është një tregues i mirë i kuptueshmërisë së tyre për rregullat e debatit të strukturuar dhe se mangësitë në këtë aspekt do të krijojnë problem në zbatimin me sukses të debateve online. 47.15% raportojnë se kanë nevojë për trajnim dhe udhëzime për të përdorur platformën online që do të përdoret. Të njëjtën kërkesë tregojnë edhe përgjigjet e dhëna nga mësuesit, të cilët kanë nevojë për trajnim dhe udhëzime për të përdorur platformën online që do të përdoret në 62.26% dhe koordinim me anëtarët e skuadrës dhe mentorin në 52.83%. Kjo nënkupton punë përgatitore nga ekipi i projektit dhe mentorëve për të mbështetur nxënësit dhe realizimi i trajnimeve që sërish do të duhet të bëhen online.

Figura 4. Nevojat e nxënësve për të realizuar debatet online në kushtet e qëndrimit në shtëpi



Nga rezultatet e pyetësorit u vu re mungesa e theksuar si në infrastrukturë edhe në kapacitete të nxënësve dhe mësuesve. Duke konsideruar mundësitë reale që kanë nxënësit për t'i realizuar debatet on-line dhe për arritjen e rezultateve: zhvillimin e mendimit kritik, analizën me argumente, komunikimin me etikë, tolerancën për mendimin ndryshe etj., mendojmë se duhet ndërtuar një strategji specifike, duke iu përshtatur nevojave të nxënësve dhe mësuesve.

Nga përgjigjet e nxënësve vihet re një situatë që favorizon përgjithësisht zhvillimin e debateve on-line apo aktivitete të tjera, pra ka një infrastrukturë të pranueshme dhe kapacitete që mund të përmirësohen. Sfida e vërtetë është motivimi i tyre për të qenë aktivë dhe produktivë në kushtet e vetë-izolimit dhe distancimit social. Të pyetur si do ta përshkruanin situatën në të cilën ndodhen aktualisht, shumica e nxënësve raportojnë se situata e re u ka bllokuar aktivitetin normal dhe u ka shkaktuar një lloj gjendjeje apatie dhe 'parazitizmi' duke mos bërë pothuajse asgjë me vlerë gjatë qëndrimit në shtëpi. Të tjerë raportojnë se i kanë ngadalësuar aktivitetet e tyre normale, por kanë filluar aktivitete të tjera në kushtet e vetë-izolimit si mësimi on-line, leximi i librave apo lundrimi në internet dhe TV. Disa prej tyre raportojnë se kjo periudhë u ka shërbyer për reflektim, megjithatë togfjalëshat më të përdorur për



këtë përgjigje të hapur kanë qenë: na ka bllokuar / jemi dembesolur / nuk kemi motivim.

Si duhet vepruar për të motivuar nxënësit? Si të kuptojmë se në këto kushte është e domosdoshme të jemi produktivë? Pra aktiviteti normal i mësimit, detyrave të kursit, aktiviteteve ekstra kurrikulare duhet të vazhdojë dhe realizimi i këtyre aktiviteteve on-line është mundësi e mirë për të njohur më mirë teknologjinë. Gjithashtu, qëndrimi në shtëpi ofron mundësi shumë të mira për të lexuar, për të mësuar një gjuhë të re, për të ndjekur performanca artistike, apo për të gatuar, për të bërë art e shumë aktivitete të tjera. Mjafton që të gjesh çdo ditë arsye për të qenë aktivë.

Është e lehtë kur mbahet një strukturë apo rutinë që fillon me vendosjen e qëllimeve apo objektivave dhe shpërblimin e vetes kur i ke realizuar ato. Kjo mund të bëhet individualisht, por edhe në komunikim dhe lidhje me bashkëmoshatarë, kolegë apo mësues. Komunikimi në rastin e distancimit social është edhe më i nevojshëm, pavarësisht se bëhet virtualisht. Mësimi on-line mund të shtojë presionin, prandaj komunikimi dhe ndarja e përvojave ndihmon shumë.

Gjatë kësaj periudhe LIBURNETIK i fton nxënësit të bëhen pjesë e nismës '#UneRriNeShtepi #SebashkuDoJaDalim', të ndajnë me të tjerët përmes fotove, videove, mesazhe pozitive se si po e kalojnë periudhën e vetë izolimit. Nxënësit mund të dërgojnë shkrime që mund të publikohen në faqen e Re-Debate mbi tema që lidhen jo vetëm me paketat e debateve të dërguara, por edhe me aktualitetin: si ka ndryshuar realiteti nga pandemia, sugjerime apo këshilla për nxënësit e tjerë që mund të shërbejnë për të qëndruar aktivë. Disa nxënës tashmë kanë filluar të dërgojnë mesazhet e tyre me video duke u bërë pjesë e fushatës ndërgjegjësuese që organizata ka ndërmarrë për të përcjellë mesazhe pozitive dhe motivuese kundër luftës së Covid-19.

Rezultatet e përfutuara nga kampioni i anketimit, të nxënësve dhe mësuesve, tregojnë për sfidën e të qenurit aktivë në këto kushte të jashtëzakonshme që po jetojmë. Pavarësisht sfidave që hasim, siç është kjo 'luftë' me një armik të padukshëm, nuk duhet të frikësohemi apo të pezmatohemi. Përkundrazi, këtë kohë vetë izolimi duhet ta shfrytëzojmë si një mundësi për të rritur vetveten dhe për t'i kushtuar kohë disa aspekteve thelbësore për rritjen e kapaciteteve personale.